REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës:	2018:049454
Datë:	16.03.2020
Numri i dokumentit:	00900116

P.nr.100/2019

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nacis Sarani procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarve M.Q dhe Sh.Q, të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale në bashkë kryerje të kanosjes nga neni 185 par.3 lidhur me nenin 31 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II nr.1790-4/2016 të datës 24.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të shtetit në Prizren M.G, të akuzuarve, si dhe avokatëve E.Gj dhe avokat Sh.B, me datë 06.01.2020, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit

1.M.Q nga i ati G.dhe nëna N. e lindur M., i lindur me datë ... në fshatin .., Komuna e Dragashit, tani me banim në Prizren, rruga "..., nr...., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar, baba i ... fëmijëve, gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. SH.Q, nga i ati G. dhe nëna N.e lindur M., i lindur me datë 18.03.1946 në fshatin Pllajnik, Komuna e Dragashit, tani me banim në Prizren, rruga "...", nr...., ka të kryer shkollën fillore, pensioner, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë FAJTOR

Se me datë 21.07.2016 rreth orës 10,45 minuta, në Prizren, në rrugën "...", në bashkë veprim seriozisht i kanosen personit zyrtarë gjeodetit, në lidhje me punën apo pozitën e tij, me fjalë, vepra apo gjeste se do ti shkaktojnë ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose shkaktimit të ankthit – të dëmtuarit: F.S, në atë mënyrë që deri sa i njëjti ishte duke shkuar në një seancë gjyqësore, rrugës takon të pandehurit dhe të njëjtit i kanosen me fjalë dhe gjeste duke i ngritur duart në drejtim të dëmtuarit dhe duke e akuzuar për një çështje civile që kishin për mendimin e dhënë nga i dëmtuari si ekspert i gjeodezisë, pastaj i vihen pas duke e ndjekur, me ç' rast me këto veprime tek i dëmtuari kanë shkaktuar ankth dhe frikë si dhe ia kanë rrezikuar sigurinë personale,

2019:073824

Kësodore kanë kryer veprën penale në bashkë kryerje të kanosjes nga neni 185 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës,

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 43 par.1 pika 1.3, 46, 73, 74, 75, 76, nenit 185 par.3 ldihur me nenin 31 KPRK-ës, te akuzuarve ju shqipton:

DENIM ME KUSHT

Të akuzuarit të pare M.Q,

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do e ekzekutohet ne afatin prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale,

Të akuzuarit të dytë Sh.Q,

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do e ekzekutohet ne afatin prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale,

Obligohen të akuzuarit që në mënyrë solidare të paguajnë shpenzimet e procedures gjyqësore dhe ate në emër të paushallit gjyqësore secili veç e veç në shumen prej 20,00 Euro, tsi dhe në emër të mbrojtjes së viktimave shumën prej 30,00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1790-4/16 të datës 24.01.2019 kundër të akuzuarve M.Q dhe Sh.Q, të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale kanosje në bashk[kryerje nga neni 185 par.3 të KP-ës

Prokurori i shtetit M.G, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: konsiderojmë se në tërësi është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, dhe ate nga provat e propozuara nga dëgjimi i dëshmitarëve si dhe vet deklaratat e të akuzuarve në shqyrtimin gjyqësor,

Është jo kontestuese se i dëmtuari F.S i cili ishte i angazhuar në cilësinë e ekspertit në gjykatën themelore në Prizren në të cilin rast të pandehurit ishin palë gjyqësore në kontest civil, për të cilin rast nga dëgjimi i të dëmtuarit dhe vet të pandehurve palët kanë arritur barazim gjyqësor.

Mirëpo, po ashtu nga vet deklarata e të pandehurve të dhëna në Stacionin policor me datë 21.07.2016, rezulton se i pandehuri i dytë sipas aktakuzës Sh.Q, së pari e ka telefonuar me telefon të pandehurin nën I M.Q, të cilin e takojë në vendin dhe kohën të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, të cilin fillimisht e kanosin kinse për shkak të ekspertizës jo profesionale tek i cili shkaktojnë frikë dhe ankth se do ti ndodh diçka e keqe, me të cilin moment sipas deklaratës të vet të pandehurit nën II Sh.Q i është drejtuar me fjalët “tash të tregoj se kush është budalla”, dhe është vërsulur drejt të dëmtuarit i cili për fat të mirë ka arritur të ik dhe të largohet nga vendi i ngjarjes për të mos ndodhur diçka më e keqe. Kjo

2019:073824

konsiderojmë se është dëshmuar edhe nga shqyrtimi gjyqësor sipas procesverbalit të datës 03.01.2020. si pasojë e ankthit dhe frikës i dëmtuari ka pas shqetësim se do ti ndodh ndonjë e keqe,.

Prokurori i shtetit konsideron se në rastin konkret në veprimet e të pandehurve inkriminohen të gjitha elementet të veprës penale të kanosjes në bashkë kryerje, fakte i cili rezulton edhe nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 03.01.2020.

Andaj propozoj gjyqtarit gjykues që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave, vlerësimit dhe analizimit të provave të merr vendim sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.Q, avokat E.Gj, në fjalën e saj përfundimtare deklaron: konsideroj që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor nuk janë vërtetuar faktet dhe provat me të cilat janë mbështetur pretendimet të prokurorisë të përshkruara në dispozitiv të aktakuzës PP.nr.1790-4/2016 të datës 24.01.2019, ku të mbrojturit tim i vihet në barë vepra penale e kanosjes në bashkë kryerje nga neni 185 par.3 lidhur me nenin 31 të KP-ës,

Andaj konsiderojmë se në këtë çështje penale nuk është vërtetuar gjendja faktike edhe ajo juridike gjatë shqyrtimit gjyqësor, e pretenduar në aktakuzë, nuk mund të vërtetohet një gjendje faktike kur gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor në favor të saj është vetëm një deklaratë dhe ate deklarata e të dëmtuarit dhe si e tillë një aktgjykim i tillë nuk mund të qëndroj.

Nga të cekurat konsiderojmë dhe i propozojmë gjykatës që në mungesë të provave konform nenit 364 të KPP-ës ndaj të mbrojturit tim të marr aktgjykim lirues.

I akuzuari M.Q, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: në tërësi e përkrahi dhe e mbështes fjalën përfundimtare avokat E.Gj, dhe për momentin skam tjetër çka të shtoj.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.Q, avokat Sh.B, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: konsideroj që në këtë çështje penale gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk janë vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të qartë provat për pretendimet e prokurorisë se në veprimet e të mbrojturit tim Sh.Q të sëhtë kryer vepra penale e kanosjes në bashkë kryerje nga neni 185 par.3 lidhur me nenin 31 të KP-ës.

Aq më shumë gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar që i mbrojturi im me asnjë fjalë e as me një veprim aktiv nuk ka vepruar në drejtim të kryerjes së veprës penale e cila i vihet në barë. Duke pasur parasysh faktin se i mbrojturi im nuk ka pasur asnjë motiv për të kryer një vepre penale të kësaj natyre, ndaj ekspertit i cili e ka bërë edhe ekspertizën në një çështje civile, në rastin konkret këtu i dëmtuari, në bazë të së cilës ekspertizë edhe është arritur barazim juridik,

Po ashtu në rast se shikojmë deklaratën e të dëmtuarit të dhënë në Prokurorin Themelore në Prizren me datë 24.08.2016 i njëjti në këtë deklaratë konkretisht në faqen e dytë në pasusin e fundit dhe ate në reshtin e tretë të sajë deklaron se është takuar me dy vëllezërit këtu të akuzuarit Sh. dhe M.Qnë vendin ku rijnë taksistat, dhe njëri prej tyre ka filluar në drejtimin tim me sharje dhe fyerje po ashtu ka ngritur edhe dorën duke më akuzuar, pra në rastin konkret vetëm njëri nga ta ka vepruar në drejtim të kryerjes së veprës penale për të cilën pretendon prokuroria, ndërsa nuk është vërtetuar me asnjë provë konkrete, fakt apo rrethanë se në veprimet e të mbrojturit tim janë plotësuar elementet e veprës penale e cila i vihet në barë.

2019:073824

Nga të gjitha këto konsideroj se në këtë çështje penale gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar vepra penale e kryer nga ana e të mbrojturit tim, andaj nga të cekurat i propozoj gjykatës
që në mungesë të provave ndaj të mbrojturit tim konform nenit 364 të KPP-ës, të marr aktgjykim lirues.

I akuzuari Sh.Q, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: në tërësi e përkrahi dhe e mbështes fjalën përfundimtare avokat Sh.B, dhe për momentin skam tjetër çka të shtoj.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike

Se me datë 21.07.2016 rreth orës 10,45 minuta, në Prizren, në rrugën "...", në bashkë veprim seriozisht i kanosen personit zyrtarë gjeodetit, në lidhje me punën apo pozitën e tij, me fjalë, vepra apo gjeste se do ti shkaktojnë ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose shkaktimit të ankthit – të dëmtuarit: F.S, në atë mënyrë që deri sa i njëjti ishte duke shkuar në një seancë gjyqësore, rrugës takon të pandehurit dhe të njëjtit i kanosen me fjalë dhe gjeste duke i ngritur duart në drejtim të dëmtuarit dhe duke e akuzuar për një çështje civile që kishin për mendimin e dhënë nga i dëmtuari si ekspert i gjeodezisë, pastaj i vihen pas duke e ndjekur, me ç' rast me këto veprime tek i dëmtuari kanë shkaktuar ankth dhe frikë si dhe ia kanë rrezikuar sigurinë personale,

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar pas shqyrtimit të gjitha shkresave dhe administrimit të provave të lëndës, dhe ate deklaratave të akuzuarve M.Qdhe Sh.Q, të dëmtuarit – dëshmitarit F.S, B.H, si dhe provave materiale dhe ate deklarata e të pandehurit Sh.Q e dhënë në procedurën parapenale në Stacionin policor në Prizren me datë 21.07.2016. deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit F.S e dhënë në procedurën parapenale në Stacionin policor në Prizren me datë 21.07.2016. deklarata e të pandehurit Sh.Q, e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, me datë 22.07.2016. deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit F.S, e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, me datë 24.08.2016. deklarata e të pandehurit M.Q, e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, me datë 22.01.2019, andaj gjykata pas shqyrtimit të gjitha provave të cekura dhe vlerësimit të të njëjtëve të gjitha së bashku dhe secila veç e veç, në rastin konkret ka vërtetuar që në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale kanosje në bashk[kryerje nga neni 185 par.3 të KP-ës duke vërtetuar paraprakisht përgjegjësin penalo juridike të akuzuarve,

Gjykata gjendjen e këtill faktike e ka vërtetuar në bazë të deklaratës të dëmtuarit - dëshmitarit **F.S**, i cili në shqyrtimin gjyqësor me datë 03.01.2020 deklaron: me profesion jam gjeodet, si dhe jam i licencuar si ekspert i gjeodezisë në gjykatë. Po në një lëndë ivile të këtu pandehurve M.Q dhe Sh.Q, po kam qenë i angazhuar në bazë të vendimit të kësaj gjykate në një lëndë civile tek gjyqtari N.K, ku kanë qenë të përfshirë këtu të pandehurit. Jo nuk ka pasur ndonjë vërejtje nga ana e këtu të pandehurve për angazhimin e juaj në cilësinë e ekspertit në rastin konkret. Në rastin konkret procedura civile tek ish gjyqtari N.K, ka përfunduar me një barazim gjyqësor, në mes të këtu të akuzuarve dhe vëllaut të tyre të tretë, emrin e të cilit nuk e di, dhe në bazë të vlerësimit tim kam bërë matjen e parcelës kontestuese, dhe të njëjtën si raport i kam parashtruar gjykatës, për çka edhe është arritur marrëveshja gjyqësore.

Në ditën kritike kam qenë duke ardhur në gjykatë, dhe tek Gjimnazi i ulët "...", përballë të njëjtës më janë afruar këtu të akuzuarit dhe nga kjo shkollë e deri te restoranti "..." e cila gjendet mu pranë prokurorisë themelore në Prizren, këtu të akuzuarit më janë kërcënuar tërë kësaj rruge, këtë e ka vërejtur edhe gjyqtari V.T, dhe i cili më ka udhëzuar dhe sugjeruar që

2019:073824

rastin ta paraqesë në polici. Ashtu edhe kam vepruar dhe kam paraqitur rastin në polici si kanosje.

Me fjalët "qe ky pisi". me këto fjalë më është drejtuar i akuzuari M.Q. Se cili nga këta të pandehur të është drejtuar me fjalën "tash të tregoj se kush është budall", ka kaluar një kohë e gjatë nga rasti si rast, dhe nuk më kujtohet se cili nga këta i ka thënë këto fjalë.

Është e vërtetë që në ditën kritike në drejtimin tim janë dëgjuar fjalët e të sharave nga e të pandehurve, e kam vërejtur që këtu i akuzuari M. e ka ngritur dorën në drejtimin tim, por nuk më ka goditur, pas tre dite ka ardhur në zyrën time në Kuvendin Komunal këtu mbrojtësi i të akuzuarit Sh.Q, avokat Sh.B, për të më lutur që ta tërhiqi deklaratën time që e kisha dhënë edhe në polici edhe në prokurori, por unë paraprakisht kam deklaruar dhe të njëjtit janë përgjigjur që nuk mundem tani ti tërheqi këto deklarata. Unë me avokatin Sh.B njihemi një kohë të gjatë, kemi bashkë punuar me vite të tëra ai si avokat, ndërsa unë si gjeodet, kemi punuar shumë lëndë së bashku në cilësi tona zyrtare, andaj ka ardhur nga kjo miqësi në emrin e tij personal që të më lus që të tërheqi deklaratat e lartë cekura.

Pas kësaj dite kritike nuk kam pasur më ndonjë frikë, shqetësim apo ankth nga të akuzuarit. Në rast se gjykata gjen se të akuzuarit janë fajtor për veprën penale jo nuk parashtroj kërkesë pronësoro juridike. Ndërsa sa i përket ndjekjes penale këtë e le në kompetencë të gjykatës dhe prokurorisë.

Kur këtu të akuzuarit janë nisur në drejtimin tim tuaj, theksova më lartë që unë kam qenë në drejtim të Gjykatës duke shkuar, nga Kuvendi Komunal ku punoj. Gjatë ecjes në drejtim të gjykatës, nga ana e kundërt kanë ardhur këtu të pandehurit, dhe në momentin që më kanë vërejtur të njëjtit e kanë ndruar drejtimin e tyre duke më ndjekur në drejtim të gjykatës ku isha nisur unë. Po ka ecur në mënyrë normale. Pas rastit të ndodhur atë ditë, nuk më kujtohet konkretisht a jam takuar me dikendë tjetër, unë atë ditë kam pasur gjykime i caktuar si gjeodez, jam takuar me gjyqtar dhe persona zyrtarë sipas punës time zyrtare. Gjatë bisedës me vëllezërit Q., kemi komunikuar në gjuhën shqipe, pasi që të njëjtën e komunikoj relativisht mirë.

Dora e M.Q në drejtimin tim ka qenë e ngritur, a ka qenë e ngritur me grusht të hapur apo me grusht të mbyllur nuk më kujtohet. Për ndryshe nuk më ka kapur për rrobat e trupit. Nga ky rast nuk kam qenë te mjeku.

Sa i përket veprimeve konkrete të akuzuarit Sh.Q, në ditën, kohën dhe vendin kritik. ka kaluar një kohë e gjatë, mua detalet nuk më kujtohen, por siç thashë më lart të dytë së bashku më kanë përcjellur nga Gjimnazi "...", deri tek lokali "...", unë për vetën time kam mundur të deklaroj shumë çka tjetër po të kisha dashur, mua më vije keq të paraqitem para gjyqtarit dhe para prokurorit, nuk është në natyrën time, prandaj veprimet konkrete të secilit këtu të pandehur në detale për shkak të kohës të kaluar me të vërtet nuk më kujtohen,

Nuk e di cili nga të pandehurit ka qenë i pari që më është afruar. Se nuk e kam përqendruar vëmendjen në afrimin e tyre, aq më shumë nuk më ka shkuar në mendje që do të më kërcënojnë – kanosin. Unë si ekspert i gjeodezisë e kam përpiluar ekspertizën, e më pas mbrojtësit dhe këtu vëllezërit Q. si palë vet kanë arritur marrëveshje juridike.

Në ditën, kohën dhe vendin kritik, këtu të akuzuarit më kanë shoqëruar nga Gjimnazi "..." deri tek restoranti "...", gjatë këtij shoqërimi nga ana e të akuzuarve në drejtimin tim janë

2019:073824

dëgjuar fjalët e sharjeve dhe banale në drejtimin tim, këto sjellje , veprime dhe fjalët nga ana e të akuzuarve tek unë si i dëmtuar sa i përket faktit a kanë paraqitur frikë, shqetësim dhe ankth. po me siguri që kanë paraqitur një shqetësim tek unë, po ashtu dua të theksoj se unë si ekspert i gjeodezisë në gjykatë ju kam shmangur edhe gjykimeve tjera në cilësinë e ekspertit të gjeodezisë diku rreth 3 javë nga dita kritike, aq më shumë që në rastin konkret këtu të akuzuarit kanë arritur marrëveshje juridike, që do të thotë marrëveshje sipas vullnetit dhe dëshirës së tyre, unë si ekspert i gjeodezisë vetëm e kam bërë ekspertizën e gjeodezisë,

Shqetësimi i lartë cekur vet vetiu e ka ndier në vete edhe lloj frike, kjo nga vet fakti që unë tre javë pas rastit ju kam shmangur seancave gjyqësore në këtë gjykatë nga ky rast, nga e tërë kjo kam pasur ankth të cilin ankth e kam qetësuar me terapione duke përdorur tableta qetësuese.

Dëmtuari – dëshmitari në fund deklaron unë në kohën kur kam përpiluar ekspertizën ka qenë para tre viteve, jam munduar që duke pasur parasysh rastin si rast, moshën e të akuzuarve, të jem në detyrat e mija profesionale që të arrij që të rregulloj çështjen e tyre pronësore, dhe për kundër kësaj këtë kanosje dhe këto veprime të cekura më lart të akuzuarve edhe ka kaluar një kohë të gjatë, por më së rëndi e kam kur po e shoh që sot në gjykim gjatë deklaratës sime këtu i akuzuari M. qesh me deklaratën time, kjo është më e rëndë për mua.

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 03.01.2020 janë administruar provat materiale dhe ate deklarata e të pandehurit Sh.Q e dhënë në procedurën parapenale në Stacionin policor në Prizren me datë 21.07.2016. deklarata e të dëmtuarit F.S e dhënë në procedurën parapenale në Stacionin policor në Prizren me datë 21.07.2016. deklarata e të pandehurit Sh.Q, e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, me datë 22.07.2016. deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit F.S, e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, me datë 24.08.2016. deklarata e të pandehurit M.Q, e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, me datë 22.01.2019.

I akuzuari **M.Q,** në shqyrtimin gjyqësor me datë 03.01.2020, deklaroi: në ditën kritike unë kam qenë me vëllaun tim Sh.Q duke ecur rrugës në drejtim të Qendrës së qytetit duke u nisur nga lagja .... Me të arritur tek shkolla ish "..." tani Gjimnazi i ulët "...", e takuam rastësisht këtu gjeometrin të dëmtuarin F.S. Të njëjtin unë me vëllaun vetëm kërkuam që të na shpjegoj rastin tonë pronësor familjar, ku i njëjti ka qenë si ekspert i gjeodezisë në çështjen tonë pronësoro familjare në mes meje dhe vëllezërve të mi Sh.Q dhe F.Q. Me vete kisha një mori dokumentesh dhe ndër to ishte edhe ekspertiza e ekspertit, kërkova nga ai vetëm të na shpjegojë këtë ekspertizë, dhe i njëjti u larguaduke na anashkaluar pyetjen tonë. Kanë kaluar tre vite e më shumë nga ky rast, unë me të vërtet nuk më kujtohet dhe nuk e di se të njëjtin në rastin konkret ta kemi kanosur, aq më shumë që ne si familje nuk jemi të kategorisë të tillë, e aq më shumë unë për shkak të gjendjes time shëndetësore nuk mund të eci shpejt, e aq më shumë ta ndjeki të njëjtin, siç përshkroi këtu i dëmtuari deri te lokali "..." pranë prokurorisë.

Jo nuk i jam drejtuar me fjalët "o pis". kam thënë nuk është e vërtet edhe pse kanë kaluar tre vite nga ajo ditë.

Po është nënshkrimi im në faqen 1 në pjesën i pandehuri M.Q, në mes të faqes të 2-të ku shënohet i pandehuri dhe në faqen e 3 ku shënohet i pandehuri M.Q, në deklaratën time të dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren nën numrin PP.nr.1790-4/2016 të datës 22.01.2019.

2019:073824

Nuk e mbaj në mend a është e vërtet që të jem drejtuar të dëmtuarin F.S me fjalët "mos më qaj kryet se i kam problemet e mija" "pse je i pa kënaqur".

Kur jam takuar me të dëmtuarin po kam qenë me vëllaun Sh.Q. Nuk e di, që në ditën kritike a më ka ftuar në telefon vëllau Sh.Q, i vetmi send që e di atë ditë është që kam shkuar në aeroport dhe kam shkuar për në Itali, ku më kanë ftuar në punë pasi që përkohësisht punoj në Itali.

Nuk e mbaj mend kush ka thënë për të dëmtuarin "qe ky pisi". Më pas i dëmtuari diçka ka thënë po çka nuk e di, pasi që kanë kaluar tre vite e më shumë. Nuk më kujtohet, kush është drejtuar me fjalët ndaj të dëmtuarit "tash të tregojmë kush është budallë". kanë kaluar më shumë se tri vite. Po theksova që ne unë dhe vëllau im Sh.Q, të dëmtuarin F. e kemi takuar rastësisht, dhe pas largimit të tij në drejtimin e tij, unë gjatë rrugës më ftuan në telefon për të shkuar në Itali ku jam përkohësisht duke punuar, unë në ditën kritike rastësisht e kam takuar të dëmtuarin F., dhe vetëm kam dashur të kërkoj nga ai një sqarim lidhur me ekspertizën e bërë nga ai, e cila për mua është mjaftë e dyshimtë, dhe sot e kësaj dite ende dyshoj në këtë ekspertizë, për çka e kam në planë që të shkoj një ditë në zyrën e tij.

I akuzuari **Sh.Q,** në shqyrtimin gjyqësor me datë 03.01.2020, deklaroi: pasi që motiv i kësaj vepre është kanosja ndaj këtu gjeodetit – të dëmtuarit F.S, i cili paraprakisht ka përpiluar një ekspertizë të gjeodezisë për çështje pronësore të familjes Q., ekspertiza e përpiluar nga eksperti i lartë cekur, ka qenë ajo ekspertizë në bazë të së cilës është marr edhe aktgjykimi civil pranë kësaj gjykate tek ish gjyqtari N.K, ky aktgjykim a më ka konvenuar mua si paditës në atë kohë, me aktgjykimin e cekur është arritur një marrëveshje në mes meje, dhe vëllezërve të mi M.Q dhe F.Q, andaj unë pasi që kam nënshkruar atë marrëveshje, dhe në bazë të kësaj marrëveshje është arritur edhe aktgjykimi i gjykatës, ekspertizën paraprake të gjeodezisë të cilën e ka përpiluar këtu i dëmtuari F.S, nuk e kam kundërshtuar. Në ditën kritike kur jemi takuar me të dëmtuarin, jo, kurrfarë fjale nuk jam drejtuar të njëjtit.

Po është nënshkrimi im në faqen 1 në pjesën i pandehuri Sh.Q, në mes të faqes të 2-të ku shënohet i pandehuri dhe në faqen e 3 ku shënohet i pandehuri Sh.Q, në deklarata time të dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren nën numrin PP.nr.1790-4/2016 të datës 22.07.2016. po qëndroj në tërësi.

Sa i përket ditës kritike kush ka përdorur fjalën "qe ky pisi", I akuzuari Sh.Q nuk dëshiron të përgjigjet në këtë pyetje duke shfrytëzuar të drejtën e mos dhënies të përgjigjes në pyetjet me të cilat konsideron që veten apo ndonjë anëtar të familjes mund ta inkriminoj para ndonjë të keqe konform dispozitave ligjore.

Në ditën kritike i dëmtuari – dëshmitari F.S jo së paku unë nuk kam dëgjua që na është drejtuar neve me ndonjë fjalë. kam dhënë deklaratën në prokurori, pranë të cilës mbetem në tërësi edhe sot.

Nga provat e administruara dhe të cekura më lartë, gjykata në mënyrë të plotë dhe të saktë ka vërtetuar në tërsi gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të aktakuzës dhe ate në bazë të deklaratës të dëmtuarit – dëshmitarit F.S, i cili në mënyrë të qartë dhe mjaft të detajuar në mënyrë kronologjike përshkruan tërë veprimet e të akuzuarve, pasi që ishte vetë i dëmtuar nga veprimet e të akuzuarve nga të cilat veprime respektivisht fjalët dhe gjestet e të akuzuarve është kanosur deri sa në ditën kritike kishte qenë duke ardhur në gjykatë, dhe tek Gjimnazi i ulët "...", përballë të njëjtës i janë afruar këtu të akuzuarit dhe nga kjo shkollë e deri te

2019:073824

restoranti "..." e cila gjendet mu pranë prokurorisë themelore në Prizren, këtu të akuzuarit i janë kërcënuar tërë kësaj rruge, Me fjalët "qe ky pisi". me këto fjalë i është drejtuar i akuzuari M.Q. Se cili nga këta të pandehur i është drejtuar me fjalën "tash të tregoj se kush është budall", ka kaluar një kohë e gjatë nga rasti si rast, dhe nuk i kujtohet se cili nga këta i ka thënë këto fjalë. Është e vërtetë që në ditën kritike në drejtimin e tij janë dëgjuar fjalët e të sharave nga e të pandehurve, e ka vërejtur që këtu i akuzuari M. e ka ngritur dorën në drejtimin e tij por nuk e ka goditur, Dora e M.Qnë drejtimin e të dëmtuarit ka qenë e ngritur, a ka qenë e ngritur me grusht të hapur apo me grusht të mbyllur nuk më kujtohet.Gjatë ecjes në drejtim të gjykatës, nga ana e kundërt kanë ardhur këtu të pandehurit, dhe në momentin që e kanë vërejtur të njëjtit e kanë ndruar drejtimin e tyre duke e ndjekur në drejtim të gjykatës ku ishte nisur i dëmtuari - dëshmitari. Sa i përket veprimeve konkrete të akuzuarit Sh.Q, në ditën, kohën dhe vendin kritik. ka kaluar një kohë e gjatë, detalet nuk i kujtohen, por të dytë së bashku e kanë përcjellur nga Gjimnazi "...", deri tek lokali "...", prandaj veprimet konkrete të secilit këtu të pandehur në detale për shkak të kohës të kaluar me të vërtet nuk më kujtohen,

Në ditën, kohën dhe vendin kritik, këtu të akuzuarit e kanë shoqëruar të dëmtuarin nga Gjimnazi "..." deri tek restoranti "...", gjatë këtij shoqërimi nga ana e të akuzuarve në drejtimin e të dëmtuarit – dëshmitarit janë dëgjuar fjalët e sharjeve dhe banale në drejtimin e tij. Këto sjellje , veprime dhe fjalët nga ana e të akuzuarve tek i dëmtuari – dëshmitari sa i përket faktit a kanë paraqitur frikë, shqetësim dhe ankth. kanë paraqitur shqetësim tek i njëjti sipas deklaratës së tij, dhe ky shqetësim si dhe kjo frikë dhe ankthë është manifestuar në drejtim se i dëmtuari – dëshmitari si ekspert i gjeodezisë në gjykatë i është shmangur edhe gjykimeve tjera në cilësinë e ekspertit të gjeodezisë diku rreth 3 javë nga dita kritike, aq më shumë që në rastin konkret këtu të akuzuarit kanë arritur marrëveshje juridike, që do të thotë marrëveshje sipas vullnetit dhe dëshirës së tyre, ndërsa dëshmitari – i dëmtuari si ekspert i gjeodezisë vetëm e kam bërë ekspertizën e gjeodezisë,

Shqetësimi i lartë cekur vet vetiu e ka ndier në vete edhe lloj frike, kjo nga vet fakti që i njëjti tre javë pas rastit i është shmangur seancave gjyqësore në këtë gjykatë nga ky rast, nga e tërë kjo kam pasur ankth të cilin ankth e kam qetësuar me terapione duke përdorur tableta qetësuese. Por më së rëndi e ka kur po e sheh që në gjykim gjatë deklaratës së tij ëtu i akuzuari M. qesh me deklaratën e tij kjo ishte më e rëndë për te

Deklaratës së lartëekur të dëmtuarit – dëshmitarit gyjkata në tërësi ja fali besimin pasi që e njëjta ishte e bazuar si dhe në harmoni dhe në përputhje edhe me provat materiale dhe ate

deklarata e të pandehurit Sh.Q e dhënë në procedurën parapenale në Stacionin policor në Prizren me datë 21.07.2016.

deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit F.S e dhënë në procedurën parapenale në Stacionin policor në Prizren me datë 21.07.2016.

deklarata e të pandehurit Sh.Q, e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, me datë 22.07.2016.

deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit F.S, e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, me datë 24.08.2016. deklarata e të pandehurit M.Q, e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, me datë 22.01.2019,

2019:073824

Provave të cekura më lartë të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata në tërësi ju fali besimin pai që të njëjtat janë identike dhe në përputhshmri të plotë me njëra tjetrën dhe si të tilla si tërësi vërtetojnë në tërësi gjendjen e plotë dhe të saktë faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës kanosje në bashk[kryerje nga neni 185 par.3 të KP-ës

.

Gjykata shqyrtoi fjalën përfundimtare të mbrojtësve të akuzuarve të cilat fjalë përfundimtare sipas bindjes së gjykatës isfin në drejtim të shmangëjes të përgjegjësisë penalo juridike të akuzuarve, por pa ofruar apo pa u mbshtetur në asnjë provë apo fakt me të cilat do të arsyetohej kërkesa për lirim nga akuza, apo mosekzistimi i elementeve të veprës penale keqëtrajtim, vepër kjo e cila ju vihet në barrë të akuzuarvet, arsyetimet e cekura se të akuzuarit nuk kanë pasur motiv e as arsye për të kanosur të dëmtuarin pasi që i njëjti si gjeodet ka përpiluar ekspertizën në një kontest civil për zgjidhjen e çështjes pronësore të familjes Q., ku si palë kanë qenë pikrisht këtu të akuzuarit dhe një vëlla i tyre F.Q, e nga e cila ekspertizë është arritur edhe marrveshja e palëve janë arsyetime sipas bindjes së gjykatës të pa baza dhe sipërfaqësore si dhe tepër të zbehta dhe si të tilla nuk mund të qëndrojnë e aq më pak që gjykata të ju fal besimin, e në drejtim të kësaj shkon edhe fakti se pas tre dite në zyrën e të dëmtuarit – dëshmitarit në Kuvendin Komunal ka shkuar këtu mbrojtësi i të akuzuarit Sh.Q, avokat Sh.B, për të lutur që ta tërheq deklaratën i dëmtuari - dëshmitari që e kisha dhënë edhe në polici edhe në prokurori, por paraprakisht i dëmtuari – dëshmitari ka deklaruar dhe të njëjtit i është përgjigjur që nuk mundet tani ta tërheqi këto deklarata.andaj sipas bindjes dhe konstatimit të gjykatës janë të pabazuara.

Deklaratës të akuzuarve M.Q dhe M.Q, të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor në mbrojtjen e tyre ku përshkruan veprimet paraprake të cekura më lartë gjykata po ashtu nuk ju fali besimin ngase të njëjtat deklarata në tërësin e tyre ishin mjaft të paqarta, në kundërshtim me vetëveten dhe me asnjë provë, fakt apo rrethanë konkrete të argumentuara dhe të provuara dhe si të tilla mjaft kundërthënëse me arsyetime “nuk mbaj në mend”, “nuk më kujtohet” për çështjet dhe faktet vendimtare të kësaj çështje penale, për çka gjykata nuk ju fali fare besimin, deklaratave të tilla gjykata nuk ja fali besimin, ngase qëllimi i të njëjtave si për faktin e cekur dhe po ashtu edhe gjatë deklaratës së tyre të dhënë në mbrojtjen e vet, sipas mendimit të gjykatës është vetëm shmangija nga përgjegjësia penale dhe vepra e cila ju vihet në barrë, ngase në bazë të provave të cekura të cilave gjykata në tërësi ju fali besimin dhe ate deklaratës të dëmtuarit – dëshmitarit si dhe provave materiale të cekura më lartë, gjykata pas administrimit të provave, shqyrtimit dhe vlerësimit të njëjtave, dhe ate secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka vërtetuar gjendjen e plotë faktike se veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale që si tërësi përbëjnë figurën e veprës penale veprës penale kanosje në bashkëkryerje nga neni 185 par.3 të KP-ës, të pëtshkruar si dispozitiv të aktgjykimit dhe për këtë vendosi që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe të gjykoj sipas ligjit si dhe paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo juridike.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur si rrethana rënduese, e si rrethanë lehtësuese është marrë sjellja korrekte e tyre pas kryerjes së veprës penale, janë persona familjar, i akuzuari M.Q është baba i dy fëmijëve ndërsa i akuzuari Sh.Q është baba i tre fëmijëve, Është hera e parë që kanë ra në konflikt me ligjin, më heret nuk kanë qenë të gjykuar, çka do të thotë se i kanë respektuar rergullat pzitive, si dhe premtimin që në të ardhmen do të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarve, moshën e të akuzuarve, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarve me gjykatën, si dhe sjelljen korrekte të tyre gjatë shqyrtimitgjyqësor si dhe pas

2019:073824

veprës penale të shkaktuar, andaj gjykata ju shqiptoi të akuzuarve secilit veç e veç dhe ate dënimin me kusht duke i vërttetuar dënimin me burgim në kohëzgajtje prej 1 (një) viti i cili denim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat të verikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë të tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.100/2020 me datë 06.01.2020

Procesmbajtësja **Gjyqtari,**
Naxhis Sharani **Luan Berisha**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate,

2019:073824